



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 115
Prishtinë, më 25 qershor 2010

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 25 QERSHOR 2010**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmuan **Sabri Hamiti** dhe **Xhavit Haliti**, anëtarë Kryesisë të Kuvendit.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 10 qershor 2010,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ripranim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit,

6. Votimi për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për Mbrojtjen e Natyrës,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit lidhur me nominimin e anëtarëve për Bordin për Ankesa të Mediave (BAM) nga Gjykata Supreme e Kosovës.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: **Mimoza Ahmetaj, Myrvete Pantina, Basri Musmurati, Ibrahim Gashi** (në emër të GP të AKR-së), **Naser Rugova** (në emër të GP të LDD-së), **Fatmir Rexhepi, Melihate Tërmkolli** (në emër të GP të AAK-së) dhe **Abdyl Ymeri**, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, propozoi që Kuvendi ta harmonizojë nenit 22.1 të Ligjit nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, me arsyetim se ishte bërë gabim teknik, në vend të 55 vjetëve ishte shënuar 50 vjet.

Kryetari hodhi në votim propozimin e kryetarit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Rezultati i votimit ishin, si vijon:

Për----- 73;
Kundër----- 2.
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë

V E N D I M

1. Neni 22.1 i Ligjit nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, i miratuar në mbledhjen plenare më 4 qershor 2010, harmonizohet si vijon:

“Deputeti, pas përfundimit të mandatit, ka të drejtë për pension suplementar, nëse detyrën e deputetit e ka ushtruar së paku një mandat dhe e ka mbushur moshën pesëdhjetepesë (55) vjeç”.

2. Teksti i harmonizuar i nenit 22.1 të Ligjit nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës, për dekretimin e ligjit.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 10 qershor 2010

Procesverbali i seancës plenare, të mbajtur më 10 qershor 2010, u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Dritan Tali** i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me punësimin e 87 zyrtarëve pa kontrata të punës në këtë ministri.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputetja **Nerxhivane Dauti** i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me procedimin e Projektligjit për sigurimet.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Dauti**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtoi pyetje kryeministrit, Hashim Thaçi, lidhur me angazhimet e Qeverisë së Kosovës për kontrollimin efektiv dhe të plotë të kufirit në veri të vendit.

Kryeministri **Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Adem Hajdaraj** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj, lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për shtyrjen e moshës së pensionimit të profesorëve universitarë të UP.

Ministri **Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Hajdaraj**.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** i parashtoi pyetje ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, lidhur me integrimin e komunitetit serb dhe njohjen e institucioneve të Republikës së Kosovës nga ana e tyre, si dhe vendosjen e simboleve të Republikës së Kosovës në komunat e Graçanicës, të Kllokotit, të Ranillugut dhe të Shtërpçës.

Ministri **Ferati** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Kurteshi**.

Deputeti **Dritan Tali** i parashtoi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Bujar Bukoshi, lidhur me tjetërsimin e një pjese të pronës së Qendrës Klinike Universitare.

Ministri **Bukoshi** iu përgjigj pyetjes së deputetit Tali.

Deputeti **Ismajl Kurteshi** i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore, si dhe efektet e privatizimit në rritjen e prodhimtarisë dhe të punësimit.

Ministri **Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Kurteshi**.

Deputeti **Naim Rrustemi** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Bujar Bukoshi, lidhur me arsyet e suspendimit të drejtorit ekzekutiv të Qendrës Klinike Universitare.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ripranim

Kryetari i informoi deputetët se komisionet kryesore dhe komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, kanë shqyrtuar Projektligjin për ripranim dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet me rekomandime.

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, **Rrustem Mustafa**, e arsyetoi Raportin para deputetëve të Kuvendit.

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin dhe ka hartuar Raportin me rekomandime, i cili përmban gjithsej 14 amendamente. Komisioni vlerësoi se dispozitat e projektligjit në fjalë, me amendamentet e propozuara, ofron një kornizë ligjore lidhur me procedurat e ripranimit. Andaj, komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë projektligji.

Pastaj, kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, dhe 14.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishin, si vijon:

Për----- 64;
Kundër----- 2.
Abstenime-----9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi Ligjin për ripranim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.

Në emër të Qeverisë së Kosovës, ministri **Bajram Rexhepi** tha se nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji është e madhe për faktin se është një ndër kriteret që Bashkimi Evropian kërkon për të arritur progres në procesin e liberalizimit të vizave.

Projektligji ka për qëllim të përcaktojë rregullat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit. Projektligji ka gjithsej 13 nene. Kostoja buxhetore e vlerësuar e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të dokumenteve të udhëtimit vlerësohet të jetë 7 milionë euro. Kjo kosto buxhetore ndërlidhet me nevojën për avancimin e teknologjisë për pasaporta biometrike, si dhe pajisjet për pasaporta biometrike. Totali i koston të vlerësuar prej 7 milionë euro, parashikohet për vitin 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

Vlen të theksohet se ky projektligj krijon të hyra për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Projektligji ka deklaraten e pajtueshmërisë të Ministrisë për Integritet Evropian, që nënkupton se është në pajtim me legjislacionin e BE-së.

I propozoj Kuvendit që ta miratojë Projektligjin për ndryshim plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Rrustem Mustafa**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Luljeta Shehu**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Riza Smaka**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Naser Rugova**, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, **Enis Kervan** dhe në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Vezira Emrush**, si dhe deputetët **Gjylnaze Sylja**, **Shkumbin Demaliaj**, **Nekibe Kelmendi**, **Radmilla Vujoviq**, **Ramadan Avdiu**, **Gani Buçinca**, **Synavere Rysha**, **Bujar Dugolli** dhe **Dritan Tali**, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ministri **Bajram Rexhepi**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60;
Kundër----- 6.
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për dokumentet e udhëtimit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri – si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Votimi për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit rregullativ të Hekurudhave

Kryesuesi i informoi deputetët se diskutimet lidhur me këtë pikë kanë përfunduar në mbledhjen plenare të mbajtur me 17 qershor 2010, por në mungesë të kuorumit për të votuar, votimi është shtyrë për mbledhjen e sotme.

Pastaj, kryesuesi e hodhi në votim kërkesën për lejimin e kompensimit për anëtarët e Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit rregullativ të Hekurudhave. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----34;
Kundër----- 25.
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi kërkesën për kompensimin e anëtarëve të Bordit dhe personelin administrativ të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, sipas pasqyrave të prezantuara.

7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e natyrës

Kryesuesi informoi deputetët se Komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e natyrës dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Kryetari i komisionit përgjegjës raportues, Naser Rugova, i arsyetoi Rekomandimet e komisionit para deputetëve të Kuvendit.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për mbrojtjen e natyrës. Rezultati i votimit ishte, si vijon

Për----- 52;
Kundër----- 7.
Abstenime-----4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Projektligji për mbrojtjen e natyrës i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripunim.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative

Kryesuesi informoi se komisioni përgjegjës raportues - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportet me rekomandime.

Kryetari i komisionit përgjegjës raportues, Esat Brajshori, i arsyetoi Rekomandimet e komisionit para deputetëve të Kuvendit.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58;
Kundër----- 3.
Abstenime-----5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën administrative i kthehet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për ripunim.

9. Shqyrtimi i Rekomandimit lidhur me nominimin e anëtarëve për Bordin për Ankesa të Mediave, nga Gjykata Supreme e Kosovës

Kryetari i informoi deputetët se komisioni funksional - Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime

Kryetari i komisionit përgjegjës raportues, Esat Brajshori, i arsyetoi Rekomandimet e komisionit para deputetëve të Kuvendit.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Rekomandimin e komisionit funksional. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 66;
Kundër----- 0.
Abstenime-----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale